



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.166/1 Prot.

Tiranë, më 19.01.2026

V E N D I M

Nr. 13, Datë 19.01.2026

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është regjistruar ankesa me nr. 235 Regj., datë 15.10.2025, e paraqitur nga z. H. N., kundër Kopshtit nr.7 “Buzëqeshja”, Bashkia Gjirokatër dhe Komisionit Multidisiplinar të Vlerësimit pranë ZVA-së Gjirokastër, në të cilën ai pretendon diskriminimin e fëmijës së tij të mitur, E. H. N., për shkak të “aftësisë së kufizuar”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: *Në cilësinë e prindërit të fëmijës tim E. N., me aftësi të kufizuara (paratetraplegjik, epilepsi dhe implant koklear), paraqes këtë ankesë për shkelje të të drejtës së tij në arsimim të përshtatshëm dhe të barabartë. E., ka ndjekur kopshtin nr. 7 “Buzëqeshja”, në Gjirokastër gjatë periudhës shtator 2024-2025. Gjatë gjithë vitit mësimor, nuk është zbatuar Plani Edukativ Individual (PEI), ndonëse ky është një detyrim ligjor. Pavarësisht kërkesave të përsëritura verbalisht në zyrën e drejtoreshës së kopshtit, nuk është marrë asnjë masë për hartimin dhe zbatimin e PEI-t për fëmijën tim. Si pasojë, gjatë periudhës 1 korrik – 5 tetor 2025, fëmija ka qëndruar në shtëpi, duke u privuar nga e drejta e tij themelore për arsimin parashkollor dhe përfshirjen sociale. Në datën 22 shtator 2025, Komisioni për Vlerësimin e Nevojave dhe Aftësive ka parashikuar që E., të ndjekë 2 orë në ditë, gjë që ne e kemi kundërshtuar ligjërisht, pasi i takon 4 orë qëndrimi në institucion, ashtu si çdo fëmijë tjetër parashkollor. Deri ditën e sotme, nuk kanë marrë asnjë vendim përfundimtar nga Komisioni,*

ndërkohë që drejtoresha e kopshtit ka ndikuar në procesin e vendimmarrjes, duke vonuar dhe penguar të drejtën e fëmijës.

Subjekti ankues i drejtohet Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, duke kërkuar ndërmarrjen e masave të mëposhtme:

1. Hetimin e rastit në lidhje me dyshimet për diskriminim institucional dhe shkeljen e të drejtës për arsim të përshtatshëm dhe të barabartë të fëmijës me aftësi të kufizuara.
2. Ndërmarrjen e masave administrative dhe ligjore ndaj institucionit arsimor, për moszbatimin e Planit Edukativ Individual (PEI), si dhe për vonesat e pajustificuara që kanë penguar ndjekjen normale të procesit arsimor nga ana e të miturit.
3. Garancinë e menjëhershme për përfshirjen e plotë të fëmijës në institucionin parashkollor, me kohëzgjatje të barabartë me atë të fëmijëve të tjerë, si dhe me mbështetje të individualizuar që i përshtatet nevojave të tij zhvillimore dhe arsimore.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Neni 5, i ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikon ndalimin e diskriminimit për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji. Sipas këtij neni ndalohet gjithashtu mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, të një ankimi ose procedure, si dhe çdo formë tjetër sjelljeje, që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Në bazë të nenit 7, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën nr. 1454/2, datë 17.10.2024, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga subjektet kundër të cilëve është paraqitur ankesa, lidhur me pretendimet e subjektit ankues, si dhe ka kërkuar dokumentacionin si më poshtë:
 - Informacion në lidhje me pretendimet e bëra nga ana e ankuesit.
 - Kopje të dosjes personale të fëmijës E. H. N., të dokumentacionit parashkollor shkollor/ligjor.
 - Informacion nga ana e Kopshtit nr.7 “Buzëqeshja” dhe Drejtorisë së Kopshteve pranë Bashkisë Gjirokastrë, nëse është hartuar një program individual edukativ i posaçëm në përputhje me nevojat e tij. Nëse po, të na vihet në dispozicion kopje e këtij PEI.
 - Informacion se cilat kanë qenë veprimet e ndërmarra nga ana e Kopshtit nr.7 “Buzëqeshja” pas kërkesave të vazhdueshme verbale të ankuesit për hartimin dhe zbatimin e Planit Edukativ Individual (PEI) për fëmijën e tij me aftësi të kufizuara?
 - Informacion dhe kopje të vlerësimit periodik të fëmijës E. H. N., nga ana e Komisionit Multidisiplinar të Vlerësimit.
 - Informacion në lidhje me veprimet e ndërmarra nga ana e ZVA-së Gjirokastrë, për vlerësimin nga komisioni multidisiplinar të fëmijës E. H. N., për vitin 2024-2025 dhe 2025-2026.
 - Kopje të vendimeve të komisionit multidisiplinar për fëmijën, E. H. N., për vitin 2024-2025 dhe 2025-2026, në të cilin janë përcaktuar nevojat arsimore të tij, rekomandimet për edukatore ndihmëse, planin mësimor dhe mjetet ndihmëse që i nevojiten për të realizuar procesin mësimor-edukativ.
 - Informacion nëse në kopshtet nën juridiksionin e ZVAP Gjirokastrë ka fëmijë me aftësi të kufizuara dhe në mënyrë të veçantë fëmijë me sidromën paraplegjik-tetraplegjik dhe a kanë programe të veçanta dhe çfarë masash janë marë për këtë kategori.
 - Si dhe çdo informacion apo dokumentacion tjetër, që ju do e gjykoni të arsyeshëm dhe do të ndihmonte në sqarimin e plotë të kësaj çështjeje.
- Me shkresën nr.20 prot., datë 27.10.2025¹, kopshti nr. 7 “Buzëqeshja”, në qytetin e Gjirokastrës, i është drejtuar me kërkesë për rivlerësimin e fëmijës E. N., Komisionit Multidisiplinar pranë Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) Gjirokastrë. Në këtë kërkesë është

¹ Administruar pranë institucionit të Komisionerit me nr. 1454/3 prot., datë 29.10.2025.

parashtruar se, pas përfundimit të periudhës dyjavore të vëzhgimit të fëmijës, nga data 10 tetor 2025 deri më 24 tetor 2025, kërkohet rivlerësimi i tij me qëllim vlerësimin e gjendjes zhvillimore dhe përcaktimin e nivelit të mbështetjes së nevojshme për përfshirjen dhe veprimtarinë e fëmijës në kopsht.

- Me shkresën nr.21 prot., datë 27.10.2025², kopshti nr. 7 “Buzëqeshja”, në qytetin e Gjirokastrës, ka kthyer përgjigje Komisionerit ku informon se:

Në përgjigje të kërkesës suaj lidhur me ankesën e paraqitur nga prindi i fëmijës E. N., ju bëjmë me dije sa vijon:

Në respekt të Ligjit Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Urdhrit Nr. 31, datë 28.01.2020 “Rregullore për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimit Nr. 16, datë 25.11.2019, Kreu II, “Për mësuesin ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar”, institucioni ynë ka ofruar mbështetje maksimale sipas nevojave individuale të fëmijës E. N.

Institucioni parashkollor Kopshti Nr. 7, Gjirokastrë, është angazhuar maksimalisht për përfshirjen dhe trajtimin me dinjitet të çdo fëmije, përfshirë edhe ata me aftësi të kufizuara.

Fëmija E. N., sipas raportit mjeko-ligjor të depozituar në dokumentacionin e fëmijës, është me diagnozë të shumëfishtë: (sindromë epileptike, epilepsi dhe sindromë epileptike të gjeneralizuar, prapambetje e rëndë mendore, dëmtime neurologjike). Gjatë vitit shkollor 2024–2025, fëmija ka ndjekur vitin shkollor dhe është asistuar nga mësuesi ndihmës gjatë gjithë vitit.

Lidhur me pretendimin për mungesën e planit PEI, ju bëjmë me dije se: Për fëmijën është hartuar dhe zbatuar plan PEI gjatë gjithë vitit duke realizuar çdo detyrë të përcaktuar në udhëzimet e punës për nxënësin me AK. Përsa i përket periudhës 1 korrik deri në 5 tetor 2025 së qëndrimit në shtëpi të fëmijës, ju informoj se: Për vitin shkollor 2025–2026, mësuesja ndihmëse filloi punë në institucion në datën 07.10.2025.

Gjatë kësaj periudhe:

- gjendja shëndetësore dhe lodhjes së shpejtë;
- vështirësive motorike dhe mungesës së plotë të ekuilibrit;
- reagimeve të shpeshta të qara dhe tërheqje në grup;
- nevojës së vazhdueshme për shërbime dhe nevojave personale.

Duke qenë se fëmija plotëson kriteret për ofrimin e shërbimeve dhe mbulimin e nevojave personale, si dhe për shkak të mungesës së specialistëve të dedikuar (terapistë fizikë dhe logopedë të

² Administruar pranë institucionit të Komisionerit me nr. 1454/4 prot., datë 29.10.2025.

përhershëm në institucion), me përfundimin e kontratës së punës së mësuesit ndihmës më 30 qershor 2025, qëndrimi i fëmijës në kopsht pa mbikëqyrje individuale u bë i pamundur, pasi kjo do të ndikonte negativisht si tek vetë fëmija, po ashtu edhe tek fëmijët e tjerë që kishin nevojë për shërbimet e specialistëve .”

Në periudhën e shkëputur me shumë dashamirësi për shoqërimin dhe mbikëqyrjen e fëmijës, prania e tij në kopsht ishte e kufizuar dhe fëmija u tërhoq nga kopshti. Bazuar në këtë situatë, e vlerësuar si të domosdoshme që fëmija të vijonte qëndrimin në kopsht për dy orë në ditë, për vitin shkollor 2025–2026. Institucioni ynë ka zbatuar Vendimin e Komisionit Multidisiplinar të ZVAP, me shkresë Nr. 702, Prot., datë 23.09.2025. Fëmija ka frekuentuar dhe ndjekur procesin mësimor që në momentin e ardhjes së tij në kopsht, në datën 08.10.2025, asistuar nga mësuesja ndihmëse.

Nuk ka pasur asnjë pengesë nga drejtoria e kopshtit, fëmijës i kushtohet vëmendja e plotë nga mësuesja ndihmëse gjatë gjithë kohës. Prindi kërkon të na imponohet për mbajtjen e fëmijës në dyfishin e kohës së qëndrimit të përcaktuar nga Komisioni Multidisiplinar, duke kontestuar vazhdimisht vendimin e Komisionit Multidisiplinar.

Për shkak të situatës së rënduar shëndetësore të fëmijës, fëmija nuk mund të përfshihet me zgjatje të qëndrimit në kopsht përtej asaj që është përcaktuar me vendim, pasi kjo do të ishte në dëm të tij. Vendimi është marrë bazuar në gjendjen e fëmijës dhe në asnjë rast si formë përjashtimi apo diskriminimi, mendime që ia kemi transmetuar edhe prindit në komunikimin e tij të vazhdueshëm.

Duke qenë se prindi nuk ka dakordësuar shqetësimin dhe kërkesa e tij është përcjellë edhe në Komisionin Multidisiplinar.

Komisioni na ka kërkuar të vihet përsëri në dispozicion dokumentacioni i nevojshëm për vlerësimin e fëmijës në një fazë tjetër. Lidhur me këtë, hapat që institucioni ynë ka ndërmarrë janë këto: U trajtua situata e krijuar në Komisionin e fëmijëve me AK të kopshtit. Në kushtet kur fëmija trajtohet me një mësuese të re ndihmëse, pasi (prindi ka pretenduar trajtimin e fëmijës me një mësuese tjetër nga mësuesja e mëparshme ndihmëse), mësueses së re ndihmëse i është dhënë kohë e mjaftueshme (2 javë) për të vëzhguar dhe vlerësuar fëmijën në të gjitha stadet e zhvillimit. Jemi në kushtet e vëzhgimit të fëmijës nga mësuesja e re, në kushtet e afatit 15-ditor të vëzhgimit që parashikon kuadri ligjor. Nga ana e institucionit tonë, pasi vëzhgimi u bë i qartë dhe i plotë mbi nevojat e fëmijës, u hartua formulari i vlerësimit (në datën 24.10.2025).

Me shkresë zyrtare, datë 27.10.2025, iu drejtuam K për rivlerësimin edhe një herë të fëmijës E. N., së bashku me dokumentacionin e vitit shkollor 2024–2025.

Kopshti është i hapur për rishikimin e orarit në çdo kohë, nëse grupi multidisiplinar ose prindi vlerëson se fëmija mund të përfitojë nga një qëndrim më i gjatë, në përputhje me progresin e tij zhvillimor.

Në përfundim, ju sigurojmë se Kopshti Nr. 7, Gjirokastër, ka zbatuar me përpikëri parimet e barazisë, përfshirjes dhe kujdesit të veçantë për fëmijët me nevoja të veçanta, duke marrë vendime të bazuara vetëm mbi kritere profesionale dhe humane.

- Me shkresën nr. 1454/5 prot., datë 03.11.2025, të Komisionerit, i janë përcjellë ankuesit shkresat nr. 20 prot. dhe nr. 21 prot., datë 27.10.2025, të Kopshtit nr. 7 “Buzëqeshja”, Bashkia Gjirokastër, duke i dhënë të drejtën për të paraqitur kundërshtimet e tij lidhur me qëndrimin e mbajtur nga institucioni.
- Me shkresën nr. 766/1 prot., datë 29.10.2025³ Zyra Vendore të Arsimit Parauniversitar Gjirokastër-Libohovë, ka kthyer përgjigje Komisionerit ku informon se:

Në përgjigje të shkresës suaj nr. 1454/2 prot., datë 21.10.2025, protokolluar pranë Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Gjirokastër-Libohovë me nr. 766 prot., datë 21.10.2025, “Kërkesë për informacion”, ku kërkon të vëmë në dispozicion informacion për vlerësimin periodik të fëmijës E. H. N., nga ana e komisionit multidisiplinar, si dhe informacion në lidhje me veprimet e ndërmarra nga ana e ZVAP Gjirokastër-Libohovë për vlerësimin nga komisioni multidisiplinar për vitin 2024–2025 dhe 2025–2026, kopje të vendimeve të Komisionit Multidisiplinar të fëmijës për të dy vitet në të cilat janë përcaktuar nevojat arsimore të tij dhe rekomandimet për mësueset mbështetëse, planin mësimor dhe mjetet ndihmëse që i duhen për të realizuar procesin mësimor edukativ, ju bëjmë me dije se:

Komisioni Multidisiplinar për vitin shkollor 2025–2026 për të vlerësuar dhe rivlerësuar fëmijët në institucionet arsimore parashkollë është bazuar në kërkesën nr. 9661 prot., datë 22.09.2025, të Drejtorisë së Arsimit pranë Bashkisë Gjirokastër, ku është dërguar lista emërore e fëmijëve të dokumentuar me AK, për t’u vlerësuar sipas secilit kopsht, ndër ta edhe E. N.

Prindi i fëmijës është paraqitur pranë komisionit në datë 23.09.2025 dhe pas vlerësimit është njoftuar që fëmija i tij do të mbështetet nga mësuesi ndihmës vetëm në dy orë qëndrimi dhe kjo për arsye se:

Fëmija E. N., ka vështirësi të cilat i burojnë nga diagnoza dhe që e bëjnë të pamundur ndjekjen e procesit edukativ dhe përfitimin në mënyrë efektive.

Diagnoza që fëmija paraqet është sindroma epileptike, epilepsi dhe sindroma epileptike të gjeneralizuara, prapambetje e rëndë mendore dhe dëmtime neurologjike. Si pasojë e paraplegjisë dhe tetraplegjisë, fëmija ka vështirësi të theksuara në motorikën fine dhe grose. Nuk ka ndërveprim social dhe nuk komunikon, nuk është i aftë të qëndrojë apo të ruajë ekuilibrin dhe nuk mund të kujdeset për higjienën personale.

³ Administruar pranë institucionit të Komisionerit me nr. 1454/7 prot., datë 06.11.2025.

Fëmija ka të vendosur në kokë një implant koklear i cili nuk duhet të preket në asnjë moment nga fëmijët e tjerë. Për të gjitha arsyet më sipër kemi kërkuar nga prindi që shoqëruesi i fëmijës të luajë rol aktiv gjatë qëndrimit të tij në kopsht, si dhe të krijojë edhe kushte të favorshme (pajisja me karrocë).

Nga ana e z. H. N., nuk është paraqitur asnjë ankesë apo kërkesë zyrtare, por në mënyrë verbale është shprehur mosdakordësi.

Ndodhur në këto kushte, ZVAP Gjirokastrë-Libohovë, me shkresë nr. 702 prot., datë 23.09.2025, ka dërguar rekomandimet e fëmijëve të vlerësuar në Drejtorinë e Arsimit pranë Bashkisë Gjirokastrë dhe është kërkuar që Komisioni Multidisiplinor t'i vihet në dispozicion dokumentacioni vjetor mbi ecurinë e fëmijës nga mësuesi ndihmës dhe mësuesja e grupit për fëmijën E. N.

Në datë 28.10.2025, pranë ZVAP-së ka ardhur një kërkesë me nr. 20 prot., datë 27.10.2025, ku kërkohet rivlerësimi i fëmijës E. N., si dhe është vënë në dispozicion dokumentacioni i kërkuar.

Komisioni Multidisiplina i Vlerësimit, me shkresën nr. 702/2 prot., datë 29.10.2025, ka njoftuar Drejtorinë e Arsimit pranë Bashkisë se komisioni do të mbledhet në datë 03.11.2025, në orën 9:00, për të bërë rivlerësimin e fëmijës.

- Me shkresën nr. 1454/8 prot., datë 07.11.2025, të Komisionerit, i është përcjellë ankuesit shkresat nr. 766/1 prot., datë 29.10.2025 e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Gjirokastrë-Libohovë, duke i dhënë të drejtën për të paraqitur kundërshtimet e tij lidhur me qëndrimin e mbajtur nga institucioni.
- Me emailin e datës 11.11.2025 nga ana e ankuesit u përcollën kundërshtimet e tij në lidhje me qëndrimin institucional të mbajtur nga ana e kopshtit ku ndër të tjera sqaron se:

Pasi është dërguar shkresa juaj institucionale, kopshti publik nr “Buzëqeshja” është përpjekur të përpilojë çdo dokument të mundshëm. Megjithëse kopshti deklaroi se është “angazhuar maksimalisht për përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara”, në praktikë, nuk është treguar asnjë bashkërendim real midis: Kopshtit “Buzëqeshja”; Zyrës Vendore Arsimore Gjirokastrë; Bashkisë Gjirokastrë; Komisionit Multidisiplinor të Vlerësimit. Angazhimi ka mbetur vetëm në nivel deklarativ, pa masa konkrete për:

- hartimin dhe zbatimin në kohë të PEI-t (Planit Edukimit Individual),
- përfshirjen e psikologut dhe mësuesit ndihmës sipas nevojës,
- komunikimin e rregullt dhe transparent me familjen.

Kjo mungesë bashkëpunimi dhe koordinimi institucional ka sjellë përjashtimin faktik të fëmijës nga procesi arsimor parashkollor, duke cënuar të drejtën e tij për arsim dhe duke qenë në kundërshtim me Ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, dhe Ligjin nr. 69/2012 “Për arsimin parauniversitar” i ndryshuar.

Plani PEI i vonuar dhe i pavlefshëm ligjërisht

Në kundërshtim me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit, plani PEI nuk është hartuar dhe zbatuar në kohën e duhur, as me pjesëmarrjen e prindit. Vetëm pas ankesës sime pranë Komisionerit, kopshti ka dërguar një dokument të vonuar që e paraqet si “plan PEI”. Ky dokument nuk mban firmën time, nuk është përpiluar në bashkëpunim, dhe nuk mund të quhet ligjërisht i vlefshëm. Në fakt, ai është përgatitur vetëm për të mbuluar mangësitë administrative dhe përgjegjësinë e institucionit.

Deklarime pa bazë mjekësore për gjendjen shëndetësore të fëmijës

Drejtuesja e institucionit ka shkruar se nga data 1 korrik deri më 5 tetor 2025, fëmija ka qenë “në gjendje të rëndë shëndetësore”, “në regjim emocional” dhe “pa vetëdije”. Ndërkohë, që fëmija nuk ka qenë në gjendje të rëndë shëndetësore.

Këto janë deklarime të pabazuara në asnjë dokument mjekësor. Asnjë raport nga mjekë specialistë apo institucione shëndetësore nuk është bashkëlidhur si provë. Një drejtues arsimor nuk ka kompetencë ligjore të vlerësojë gjendjen shëndetësore të një fëmije dhe, në mungesë dokumentacioni, këto deklarime përbëjnë shkelje të etikës profesionale dhe dinjitetit të fëmijës. Pretendime të pavërtetuara për sjelljen e prindit

Në shkresë thuhet se “prindit iu kërkua me dashamirësi të shoqëronte fëmijën për mbikëqyrje, por ai refuzoi.” Në lidhje me pretendimin e mësipërm, sqaroj se:

- *Ky pretendim është i pabazë, pasi nuk ekziston asnjë dokument i nënshkruar prej meje që të provojë një kërkesë të tillë.*
- *një institucion nuk ka të drejtë t'i kërkojë prindit të zëvendësojë mësuesin ndihmës apo personelin mbështetës, sepse kjo është përgjegjësi ligjore e institucionit publik.*

Prindi, në këtë rast, ka kërkuar vetëm zbatimin e të drejtave ligjore të fëmijës dhe ka bashkëpunuar vazhdimisht për mbështetjen e tij.

Përveç mungesës së bazës fizike dhe logopedike, në kopshtin ku ndodhet E. nuk ka pasur asnjëher psikolog të angazhuar për të ndihmuar fëmijët me aftësi të kufizuara dhe nevoja të veçanta. Kjo ka krijuar një boshllëk të veçantë, duke i lënë ata pa mbështetje profesionale, gjë e cila është thelbësore për zhvillimin emocional dhe social.

- Me shkresën nr. 1454/9 prot., datë 17.12.2025, të Komisionerit, drejtuar Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Gjirokastër-Libohovë, është kërkuar informacion në lidhje me kërkesën për rivlerësimin e fëmijës E. N., nga Komisioni Multidisiplinar i datës 03.11.2025.
- Me shkresën nr.766/3 ⁴ prot., datë 22.12.2025, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Gjirokastër-Libohovë, ka dërguar informacion në lidhje me rivlerësimin e fëmijës E. N., nga Komisioni Multidisiplinar i datës 03.11.2025, ku informon se: Në përgjigje të shkresës suaj Nr. 1454/9 Prot, datë 17.12.2025, protokolluar pranë Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Gjirokastër-Libohovë me Nr. 766/2 Prot, datë 22.12.2025, “Kërkesë për informacion”, Ju bëjmë

⁴ Administruar pranë institucionit të Komisionerit me nr. 1818 prot., datë 24.12.2025.

me dije se: *Duke marrë shkas nga kërkesa e prindërve, me të cilën jemi vënë në dijeni nëpërmjet Komisionerit, si dhe duke u udhëhequr nga parimi i interesit më të lartë të fëmijës, synohet garantimi i barazisë së shanseve, krijimi i mundësive të nevojshme dhe ofrimi i përkrahjes së vazhdueshme për mirëqenien, zhvillimin e gjithanshëm dhe përfshirjen e plotë të fëmijës me aftësi të kufizuara, në përputhje me nevojat e tij individuale, ditën e hënë, datë 03.11.2025 është mbledhur Komisioni Multidisiplinar i Vlerësimit dhe ka vendosur që nxënësi E. N., të frekuentojë kopshtin 4 orë në ditë dhe të shoqërohet nga mësuesja ndihmëse gjatë qëndrimit në kopsht. Komisionit Multidisiplinar të Vlerësimit në përfundim të vlerësimit të fëmijës ka dërguar rekomandime pranë drejtorisë së kopshtit për hartimin e planit PEI si dhe për orarin që fëmija do të ndiqet nga mësuesja ndihmëse.*

- Me email datë 12.01.2026, ankuesi z. H. N., me lëndë: “*Tërheqje nga ankesa*”, informon se pas ankesës së bërë me nr. 235 Regj., datë 15.10.2025, pranë Komisionerit për Mbrojtje nga Diskriminimi, lidhur me këto çështje kryesore: 1) *ndryshimin e orarit të mësueses ndihmëse nga dy orë në katër orë në kopsht, të vendosur nga komisioni multidisiplinar dhe drejtoresha e kopshtit; 2) mosofrimin e ndjekjes së kopshtit për periudhën nga 01.07.2025 deri më 05.10.2025*, bën me dije se falë ndërhyrjes dhe angazhimit serioz nga ana e institucionit të Komisionerit, çështja është zgjidhur me sukses dhe, për këto arsye, tërheq ankesën e sipërpërmendur, duke shprehur falënderimet për bashkëpunimin dhe ndihmën e madhe të dhënë në këtë çështje delikate.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se kërkimi i palës ankuese, pra ajo që synohet të arrihet nëpërmjet paraqitjes së ankesës objekt shqyrtimi dhe fillimit të kësaj procedure administrative, është përmbushur, pasi nga mbledhja e Komisionit Multidisiplinar të Vlerësimit, e zhvilluar më datë 03.11.2025, është vendosur që nxënësi E. N., të frekuentojë kopshtin për 4 (katër) orë në ditë dhe të shoqërohet nga mësuesja ndihmëse gjatë qëndrimit në kopsht, si dhe janë dhënë rekomandimet përkatëse për hartimin e Planit Edukativ Individual (PEI) dhe për përcaktimin e orarit të ndjekjes nga mësuesja ndihmëse, në përputhje me nevojat individuale të fëmijës dhe parimin e interesit më të lartë të tij.”

Në nenin 32, pika 3, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar përcaktohet: “3. *Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj.*”

Neni 90, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative (K.P.A), ka parashikuar se: “*Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ*”.

Në nenin 94⁵/1 të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, të ndryshuar, parashikohet se: *“Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”*.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se qëllimi për të cilin procedimi administrativ ka filluar mbi bazën e ankesës së palës ankuese është përmbushur në thelb, pasi u zgjidh problematika e adresuar pranë Komisionerit.

Për rrjedhojë është përmbushur edhe qëllimi i ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, për sigurimin e të drejtës së çdo personi për:

- “a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji;*
- b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike;*
- c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin”*.

Përfundimisht, referuar sa më sipër, si dhe duke mbajtur në konsideratë:

- Masat konkrete dhe efektive të ndërmarra nga ana e institucioneve përgjegjëse, përmes vendimmarrjes së Komisionit Multidisiplinar të Vlerësimit të datës 03.11.2025, për frekuentimin e kopshtit nga nxënësja E. N., për 4 (katër) orë në ditë dhe shoqërimin e saj nga mësuesja ndihmëse gjatë qëndrimit në kopsht, si dhe dhënien e rekomandimeve për hartimin e Planit Edukativ Individual (PEI);
- Përmbushjen e qëllimit për të cilin ishte iniciuar ankesa konkrete, në drejtim të garantimit të interesit më të lartë të fëmijës, barazisë së shanseve dhe ofrimit të mbështetjes së nevojshme për përfshirjen e plotë të fëmijës me aftësi të kufizuara në procesin arsimor;
- Qëllimin parandalues të LMD-së, ndërgjegjësimin dhe ndërmjetësimin për zgjidhje miqësore dhe zbatim efektiv të tij, dhe jo vetëm karakterin konstatues dhe ndëshkues të vendimmarrjeve të KMD-së;”

Komisioneri arrin në përfundimin se, procedura administrative për shqyrtimin e ankesës me nr. 235 Regj., datë 15.10.2025, e paraqitur nga z. H. N., kundër Kopshtit nr.7 “Buzëqeshja”, Bashkia Gjirokatër dhe Komisionit Multidisiplinar të Vlerësimit pranë ZVA-së Gjirrokastër, duhet të deklarohet e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, për shkak se qëllimi për të cilin ka filluar procedimi administrativ është përmbushur në thelb, problematika e adresuar pranë Komisionerit është zgjidhur, si dhe për shkak të tërheqjes së subjektit ankues nga ankesa⁶.

PËR KËTO ARSYE:

⁵ *“Tërheqja e ankesës”*.

⁶ Për analogji citojmë vendimet e KMD-së: Nr. 107/2024, Nr. 181/2024.

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe nenet 32 e 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës me nr. 235 Regj., datë 15.10.2025, të paraqitur nga z. H. N., pa një vendim përfundimtar, pasi është arritur qëllimi dhe efektiviteti për të cilin ka filluar procedura administrative.
2. Rekomandohet që Drejtoria e Kopshtit nr. 7 “Buzëqeshja”, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Gjirokastrë-Libohovë, Bashkia Gjirokastrë dhe strukturat mbështetëse pranë ZVAP-së, të marrin masa për:
 - hartimin, miratimin dhe zbatimin efektiv të Planit Edukativ Individual (PEI) për fëmijën E. N., në përputhje me nevojat e tij individuale dhe kuadrin ligjor në fuqi;
 - garantimin e përfshirjes së plotë të fëmijës në institucionin parashkollor, me kohëzgjatje të barabartë me atë të fëmijëve të tjerë parashkollorë (4 orë në ditë), pa vonesa apo kufizime të pajustificuara;
 - sigurimin e një mësueseje ndihmëse të përhershme, e cila të jetë e pranishme gjatë gjithë kohëzgjatjes së qëndrimit të fëmijës në kopsht, përfshirë edhe gjatë sezonit veror;
 - përfshirjen e vazhdueshme të psikologut dhe specialistëve të tjerë mbështetës, sipas nevojave të fëmijës, në kuadër të zbatimit të PEI-t;
 - marrjen e masave konkrete nga ana e ZVAP-së dhe Bashkisë Gjirokastrë, për monitorimin, koordinimin dhe garantimin e zbatimit të këtyre masave, me qëllim parandalimin e rasteve të ngjashme në të ardhmen”.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA